



PROCESVERBAL II/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi:	KK Suharekë
Zyra:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Data:	21.02.2023
Ora :	13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-Statutit të bibliotekës së qytetit “Hajdin Berisha” në Suharekë;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022 i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Shirokë;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Biraq;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për fshatin Delloc;
7. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Liridon Fandaj - kërkoj sqarime për pikën e rendit të ditës e cila është tërheq me kërkesën e Kryesuesit.

Kryesuesi - thotë që paraprakisht ju kam informuar dhe tutje jep sqarime rreth tërheqjes së asaj pike.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Statutit të bibliotekës së qytetit “Hajdin Berisha” në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Avni Bytyqi - si kryesues i komisionit flet për procedurat rreth hartimit të këtij dokumenti dhe thotë që statuti është në harmoni dhe përputhshmëri me ligjin për bibliotekat të viti 2013 i cili është i plotësuar dhe i ndryshuar në vitin 2019.

Dardan Berisha - kur e kemi bërë planin e punës kam ngrit shqetësim për aktivitetet politike që po mbahen brenda në bibliotekë. A e ndalon ky statut zhvillimin e aktiviteteve politike brenda bibliotekës?

Avni Bytyqi - gjatë takimeve me grupin punues e kemi diskutu këtë çështje mirëpo në kuadër të statutit të bibliotekës e kemi parapa që Drejtori i bibliotekës në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës të nxjerrë akte

të përgjithshme të bibliotekës dhe në kuadër të akteve të përgjithshme ne ta nxjerrim një vendim të veçantë me të cilin vendim ti ndalojmë këto aktivitete.

Urim Suka - ne e mbështesim këtë pikë për me shku në Asamble. Do ta trajtojmë dhe nëse kemi ndonjë shqetësim apo vërejtje, ne do ta adresojmë në Asamble.

Sanie Kuçi - çfarë statuti ka pasur biblioteka jonë më herët dhe a ka pas statut?

Avni Bytyqi - fatkeqësisht biblioteka jonë deri më tani nuk ka pas statut.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022 i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01-Nr-016-25493 i datës 28.04.2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kur të vje diçka që duhet mu ndryshu, është mirë me i përcjell vendimet që janë marrë paraprakisht për të njëjtën temë në mënyrë që të jemi më të informuar. Për deri sa është një vendim për dhënie në shfrytëzim, për deri sa është formu një komision dhe për deri sa është bërë një kontratë, tash po na vje ndryshimi. Ky ndryshim që po na vje, a e prek kontratën? A ka të drejtë komisioni që pe formojmë ne me ia dhënë këtë detyrë shtesë? A është kompetencë e këtij komisioni që ta bëjë vlerësimin apo duhet ta bëjë zyra ligjore e Ministrisë së Financave? Kërkoj interpretim ligjor se a kemi apo jo të drejtë me marrë një vendim të tillë?

Kryesuesi - për shkak të vonësave që janë bërë, ke të drejtë por nuk janë fajet e ekzekutivit. Sa i përket pjesës se a ka të drejtë ky komision ta bëjë vlerësimin, këtu kemi të bëjmë vetëm me nxerrjen e përqindjes së ndërtimit dhe nuk ka diçka tjetër.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime sa i përket kësaj pike.

Urim Suka - a kemi të drejtë ligjore dhe a e prek kontratën?

Avni Bytyqi - në kontratë ne i kemi rregullu procedurat dhe marrëdhëniet kontrakturë në mes dy palëve në fillimin e procedurës së punimeve dhe ndarjen e objekteve. Në kontratë i kemi dhënë kompetencë ekzekutivit dhe legjislativit që ta bëjë ndarjen.

Urim Suka - a duhet me qenë komisioni ma profesional për këtë çështje?

Avni Bytyqi - po, të gjitha komisionet që themelohen në Kuvendin e Komunës duhet të jenë persona të fushave të caktuara me të cilat caktohen.

Dardan Berisha - Unë kam qenë në mandatin e kaluar në komision dhe kjo ka qenë pika e fundit ku nuk e kemi arrit finalizimin, te kompensimi sepse kemi hy në zgjedhje dhe na ka ra mandati.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne kemi has në pengesa nga ana e palës dhe si komision kemi ardhë në atë fazë, e kemi bërë një raport deri te gjendje finale edhe pse kemi ngec dhe komplet lënda ka vazhdu në mandatin e dytë. Në takimin e fundit që e kemi mbajtur z. Bashkim Hoxha ka kërku kompensimin e objektit në objektin e ri, e që është e drejtë por çështja e dytë që ai ka kërku është e pa plotësueshme për mendimin tim dhe dua ta pyes Avniun dhe Visarin se a është qartësu që ajo çështje që ai ka kërku nuk kompensonet.

Avni Bytyqi - jep sqarime rreth kësaj çështje dhe thotë që në moment kur janë gjet kontratat të cilat kanë qenë në drejtorinë e urbanizmit, ne kemi konstatu që ai ka blerë banesa. Kuvendi dhe Komuna e ka për obligim që t'ia kompensojë metër për metër katror në objektin e parë të banimit.

Visar Kuçi - sa i përket komisionit kur të fillojmë ne ta vlerësojmë atë pjesë për m² që ka Bashkimi dhe për pjesën që ai po kërkon, nuk do të thotë që: p.sh. sa herë ti ketë 80 m² ne do t'ia japim 80 m² si komision sepse janë anëtarë profesionalë që kalkulojnë. Ne si komision do ta shqyrtojmë atë kërkesë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - sa i përket pjesës së dytë, a keni Bisedu me Bashkimin?

Visar Kuçi - drejtori jep sqarime dhe thotë që përgjithësisht Bashkimi është pajtu.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ai e ka një vendim të gjykatës që parcela është në barazim gjyqësor, ku ai kërkon 100 % të shfrytëzimit të tokës së vet. Ajo ka qenë pengesa më e madhe dhe për mendimin tim është e pa realizueshme. Këtë desha ta di se a kanë shtjellu paraprakisht.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor thotë: nuk ka vendim gjyqësor dhe nuk ka vendim prej ministrisë i cili mund ta përcaktojë çështjen e lëshuarës së lejes së ndërtimit pronësore që menaxhohen nga Komuna. I vetmi organ i Komunës për të lëshuar leje ndërtimi është drejtoria për Urbanizëm.

Liridon Fandaj - për projekt-vendimin me ligjin për vetëqeverisjen lokale neni 40.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor thotë që ligji për vetëqeverisjen lokale neni 12 i jep kompetencë dhe mandat Kuvendit të nxjerr vendime, statutin, rregulloren e punës dhe vendime tjera që janë në funksion të ekzekutivit. Neni 40 ekskluzivisht është kompetencë e Kuvendit që nxjerr vendime rreth këtyre çështjeve.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

4 për, 3 abstenime

Miratohet pika 3.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Shirokë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - mirë që jepet mundësia që pas miratimit të PZHK-së HZK-së që ne me u inkuadru me planet rregulluese sepse disa zona janë shumë të rëndësishme. Kisha kërku nga drejtoria e Urbanizmit që për këto tre plane që kanë ardhëmen na sjell një hartë që të paktën me u definu zonat dhe ta kemi si informacion se ku gjendet saktësisht ajo zonë që planifikohet me u bo si Plan rregullues.

Visar Kuçi - i kemi bo gati dhe do ti sjellim në Asamble.

Urim Suka - shumicën e temave që ngriti Sania, pajtohem sepse edhe unë të njejtat shqetësime i pata. Ne e kemi shfuqizu Z. Industriale në Shirokë. A i bie që kjo është vetëm çështje teknike sepse plani është, apo ka me u bo edhe ndonjë ndryshim?

Visar Kuçi - Zona Industriale e ka pas një plan rregullues por me hyrjen në fuqi të HZK-së, të gjitha planet kanë rënë posht. Ne i kemi lënë në fuqi këto dy plane mirëpo Ministria na ka kthyer. Plani i kaluar dhe Hartat Zonale na shërbejnë shumë në hartimin e planit të ri.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Zona industriale është pothuaj e tëra e ndërtume por licencimi i Zonës varet prej një plani rregullor. Detyra shtesë që i bie Komunës, është me i legalizu objektet të cilat e kanë ndërru destinimin gjatë punës që e kanë bërë.

Urim Suka - Drejtori po thotë që është emergjente. Pse është emergjent plani? Ne nuk kemi nevojë me bo një plan të keq por të mobilizohemi sa ma shumë që me qenë plani sa ma i mirë i mundshëm që në implementim mos me pas pasoja.

Visar Kuçi - P.sh. nëse një investitor e ka marrë një kontratë në Z.I. dhe në kontratë e ka përshkrimin se çka ka me investu dhe neve na ndryshojnë disa gjëra te lejet ndërtimore me hartat Zonale. Për këtë e kemi me patjetër me rujt zonën.

Liridon Fandaj - në bazë të asaj që kërkuat, atëherë ato kontrata duhet të bien poshtë.

Visar Kuçi - ne i marrim për bazë ato kontrata.

Liridon Fandaj - nëse është veprimtari bujqësore dhe do ta kthejë në gurrthyes. A bëhet?

Visar Kuçi - pikërisht për këtë, do ta mbrojmë zonën.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që si bazë e kemi planin aktual rregullues, që e kemi shfuqizu, por kemi gabu që i kemi shfuqizu Zonat. U desh me i dërgu në gjykatë supreme për arsye sepse është një ndër zonat e licencuara nga Ministria dhe të cilat janë të ndara në tërësi.

Urim Suka - ne i dijmë problemet në aspektin e kontratave dhe nëse është një mundësi, përmes këtij plani me u rregullu sepse janë biznese që po funksionojnë edhe pse ndoshta e kanë ndërru veprimtarinë. Brenda ligjit dhe mundësive ligjore, nëse është mundësia me iu dal në ndihmë atyre bizneseve dhe të rregullohen.

Liridon Fandaj - te kontratat e reja, duhet të parashihet diçka nëse dikush dështon në biznes dhe do të tërhiqet, dhe Komuna vendos t'ia jep dikuj tjetër.

Avni Bytyqi - në momentin që investitori ka investu, ne e kemi për obligim si Komunë që ta themelojmë një komision me ekspertë të fushave të caktuara dhe ta bëjmë rivlerësimin e objektit dhe normal që do t'ia kompensojmë.

Visar Kuçi - besoj që gjatë hartimit të planit rregullues do të kërkojmë nga komisomi që t'na furnizojnë me këto materiale.Zona ka shumë probleme te ndarjet me pronat e investimeve.

Avni Bytyqi - plani rregullues që u shfuqizu nuk e lejon ndarjen por e lejon bashkimin.

Urim Suka - është duke u bërë plani i ri rregullues dhe në qoftëse ato objekte janë funksionale,kanë shumë punëtorë,a ka mundësi me këtë plan rregullues me iu rregull të drejtën e tyre që ata me pas të drejtën e funksionimit dhe të licencohen në Ministri.

Avni Bytyqi - e drejta e bartjes së shfrytëzimit tek pala e tretë ekskluzivisht është e ndaluar me ligj.

Armend Krasniqi - Nëse komisioni i rekomandon Kryetarit,duhet 90 % të kontratave me i shkëput sepse nuk ka asnjë operatorë ekonomike që i përmbahet kontratës së rregullt.Mirëpo ne nuk mund ta prishim gjithë zonën industriale.Me plan ri-rregullues të zonës mendoj që kanë me ju zgjidh shumë probleme duke iu përshtatur bizneseve vepruese.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

6 për,1 apstenim

Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për zonën industriale Biraq;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - te Zona në Biraq,a bën me specifikum më saktë se ku e keni mendu?

Visar Kuçi - te dalja e autostradës.

Urim Suka - a janë të përfshira edhe 5 hektar që ne i kemi nda për varreza?

Visar Kuçi - po,ne i kemi përfshirë edhe varrezat e Bllacës në mënyrë që të hynë në pjesën e planit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të Hollësishëm për fshatin Delloc;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - ky 82 ha te Delloci a përfshin zona publike, zona private dhe zona të mbrojtura?

Visar Kuçi - zona të mbrojtura nuk përfshin por është zonë kadastrale e Dellocit dhe mali i Sharr prek një pjesë në zonë kadastrale të Dellocit. E drejta jonë është të merremi vetëm me pjesën që i takon Komunës. Të gjitha janë prona private.

Urim Suka - nëse janë zona private,a u desh me bisedu me banorë?

Visar Kuçi - pasi që ju na jepni kompetencat neve me inicu procedurat,ne nisim procedurën,dalim në teren dhe flasim me secilin banor.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Enver Shabani - ne si drejtori e kemi pas obligim që duhet mi ripërtëri kohë pas kohe këto rregullore.

Jemi duke punu me agjencinë japoneze për bashkëpunim dhe kemi kontratë më të gjatë se dy vjeçare.

Kemi prezente edhe avokaten Valtida Shukriu e cila e ka përgatit rregulloren bashkë me ne.

Urim Suka - kam pas shqetësim për deponinë e mbeturinave në Z.I. dhe ju më keni thënë që kjo ka afat

një vit. Kjo rregullore a e largon këtë problematikë?Pra, a do të largohet deponia në Z. Industriale dhe a do të shkojnë në Landovicë?

Enver Shabani - mbeturinat në Shirokë janë të ngurta kurse në Landovicë kanë me vazhdua me shku për mbeturinat e amvisërisë dhe të tjera. Deponia në Shirokë këtë vit do të mbyllet.

Avni Bytyqi - me 07.07.2024 do të mbyllet. Komuna nuk ka të drejtë me bo deponi për amvisni sepse është deponia regjionale në Prizren ndërsa për mbeturina të ngurta Komuna e ka obligim ligjor.

Urim Suka - kërkoj elaborim në pika të shkurtra, specifikisht çfarë të mire sjell te qytetarët.

Valtida Shukriu - rregullorja ka pësu disa prej ndryshimeve të cilat janë dakordu në bazë të planit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe pritet që Komuna me satndardizu shërbimin e grumbullimit të marrjes së mbeturinave, riciklimit dhe dorzimit të mbeturinave. Është një ndryshim që ka ardhë nga pjesa qëndrore dhe si rezultat të gjitha Komunat kanë me pas këtë ndryshim të tarifës. Vlera ka rritje prej 1.50 euro. Kjo është rezultat që është pjesë e sistemit të ekonomisë dhe inflacionit por ndikim i madhë ka ardhë nga rritja e vlerës së deponive kryesore.

Enver Shabani - jep sqarime se si ka ardhë deri te rritja dhe thotë që rritja është rreth 33 %.

Liridon Fandaj - 1.50 euru dikush nuk i ka dhe nuk caktohet çmimi në bazë të derivateve ose rritjes së inflacionit sepse sot e ke 1.45 dhe nesër bie 0.99 cent.

Enver Shabani - prej mbas lufte eko regjioni funksionon si funksionon por nuk arrin asnjëherë me ble kamion vet, pa ndihmën e Agjencisë japoneze ose Gizit gjerman.

Salih Elshani - pse Komuna me i inkasu paratë?

Enver Shabani - ajo ka me qenë faza e dytë. Nëse kalon rregullorja, Komuna ka me inkasu.

Salih Elshani - a keni kapacitet njerëzore me bo këtë punë?

Enver Shabani - po. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - a ka mundësi çmimi me mbet si ka qenë dhe pjesa që duhet mu rrit, me qenë buxhet i Komunës dhe çmimi me dal 4.50 euro për qytetarë dhe pjesa që ka mu mbulu me qenë e Komunës. Kjo me mbet për një periudhë 2-3 vjeqare. A është mundësia me u mbulu nga Komuna?

Enver Shabani - unë nuk kam të drejtë të them as po dhe as jo, është Asambleja.

Kryesuesi - faktikisht, në një formë Komuna e subvencionon 1.50 euro, për gjendjen aktuale që jemi dhe për bashkëpunimin që ka Komuna me eko regjionin, pos 13 mijë familjeve që paguajnë edhe Komuna i jep 137 mijë euro për çdo vit.

Enver Shabani - po mos të ishte kjo, nuk mund të ekzistojë eko regjioni.

Urim Suka - në kontratë të eko regjionit ka shumë pozicione që figurojnë dhe pare të mëdhaja paguhen dhe punët nuk kryhen.

Kryesuesi - për momentin gjendja është mirë dhe eko regjioni punon mirë.

Valtida Shukriu - krejt ato që thamë kanë qenë pikat që grupi punues i ka paraqit para meje. Njëra prej arsyeve për me i pas kontrollet nda j eko regjionit, me ligj është e përcaktuar që inkasimi të bëhet nga Komuna. Avokatja tutje jep sqarime dhe thotë që është bërë për herë të parë kategorizimi individ-njesi familjare. Ndërkombëtarisht kalkulimi i mbeturinave bëhet për person. Te personat që jetojnë vet, tarifa ka mbet 4.50 euro.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

4 për, 3 kundër
Miratohet pika 7

Pika 8.

Enver Shabani - është plan 5 vjeqar. Me këtë e shohim se si ka me u zhvillu grumbullimi, klasifikimi dhe ndarja e mbeturinave dhe nëse arrijmë te faza e fundit është edhe riciklimi.

Kryesuesi - e hedh në votim.

4 për, 3 apstenime
Miratohet pika 8

Dafina Haziraj